



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 546/1 prot.

Tiranë më 26.5.2020

Lënda: Mendim mbi një projektligj

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj dërguar nëpërmjet e-mailit të datës 14.05.2020, administruar me tonën nr. 546 prot., datë 15.05.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me qëllim garantimin e masave për sigurinë e të dhënave personale që do të përpunohen në Sistemin e Informatizuar të Menaxhimit të Armëve, sugjerojmë që pas pikës 3 të nenit 9 të projektligjit, të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Sistemi i Informatizuar i Menaxhimit të Armëve, ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohen masat për sigurinë e të dhënave personale, parimi i mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit lidhur me përpunimin e të dhënave, si dhe evidentimi i gjurmimit të përpunimit të të dhënave”.

Gjithashtu, sugjerojmë që në fjalinë e fundit të pikës 6, të nenit 9, togëfjalëshi “...do të rregullohet nga legjislacioni i ligjit për mbrojtjen e të dhënave”, të ndryshohet në “...kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme, projektligji vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi